



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 63 Datë 18.08.07

PËR
MIRATIM FONDI PREJ 620.000 LEKE PËR SHFAQJEN "PUTHJA"
TË TEATRIT A.Z.CAJUPI

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Financës për "PËR MIRATIM FONDI PREJ 620.000 LEKE PËR SHFAQJEN "PUTHJA" TË TEATRIT A.Z.CAJUPI", bazuar ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32. pika "dh", ligjin nr 8379 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal". Ligji nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007". Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr 2 dt.02.02.2007 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007», mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 620.000 lekë për shfaqjen « Puthja » të Teatrit A.Z.Cajupi
2. Ky fond do të përballohet nga fondi i aprovuar me V.K.B nr 2 dt. 02.02.2007 për Festivalin e Komedisë « Ballkan 2000 »
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sektori i Kulturës në Bashki dhe Qendra Ekonomike e Kulturës (Teatri).
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Rajmonda NASE
Rajmonda NASE